

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË
Dt.16.09.2025

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“REHABILITIM I DIGËS SË REZERVUARIT PEPEL 1, BASHKIA DROPULL”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):45210000-2

VLERA E FONDIT LIMIT:77.719.265 (Shtatëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e nëndëmbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë)lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Dropull** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26 dhe 29 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023, 2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023, 2024**, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c ”c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2025 (këstet e maturuara)** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per proceduratatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përllëgoaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se dyfishit** të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- a) Kontratën e Sipërmarrjes,*
- b) Situacionin përfundimtar të objektit*
- c) Aktin e Kolaudimit të objektit*
- d) Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*
- e) Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*

b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- a) Kontratën e Sipërmarrjes,*
- b) Situacionin përfundimtar të objektit*
- c) Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
- d) Aktin e Kolaudimit të objektit.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të

kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjië, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, *Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*” të ndryshuar, e cila përfshin kategorite e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- N.P-1 B** (Punime germimi ne toke)
- N.P-4 A** (Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale)
- N.P-5 B** (Punime nentokesore, ura vepra arti,)
- N.P-6 B** (Diga dhe Tunele Hidroteknike)
- N.P- 9B** (Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime)
- N.P-12 A** (Punime te inxhinjerise se mjedisit)

Për punimet speciale të ndërtimit:

- N.S - 18 B** (Punime topogjeodezike,)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategorite dhe nivelet e licencave të kërkuara janë bazuar në Lidhjen 2,3 dhe 4 të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

KAT.	PERSHKRIMI I KATEGORISË SIPAS LEGJISLACIONIT TË FUSHËS	NR. AN	ZËRAT E PUNIMEVE QË PARASHIKOHEN TË KRYHEN NË PREVENTIV, QË PËRFSHIHEN NË KATEGORINË PËRKATËSE	NIVELI I KLASIFIKIMIT I KËRKUAR PËR KATEGORINË RESPEKTIVE
NP-1	Punime gërmimi në tokë	3.106/a	Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, prani uji ~ 2m kategoria IV, me shk në mjet	Niveli B
		3.158/4	Transport dheu me auto deri 4.0 km	

		3.112/b	Pastrim rezervuari heqje aluvionesh, pjesa fundore e diges	
		3.124/2	Germim shkemb i forte me çekiç me ekskavator me zinxhir	
		3.89/b	Germim me ekskavator krahegjate , me gjatesi krahu mbi 20m	
		An-1	Mbushje me argjile, hedhje, rrafshim e ngjeshje dheu ne trup dige me cilinder me dhembe	
		3.25/a	Germim me krahe ne seksion te detyruar me gjeresi $b > 1$ m, $h=1.5$ m, toke e bute.	
NP-4	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale	2.701	Shtresë çakëlli	Niveli A
		2.262/5	Shtrese betoni C20/25 ushqyesi ne derdhje	
NP-5	Punime nentokesore, ura vepra arti	3.366	Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni	Niveli B
		An	Shtrese me gur te sortuar t (15-25) cm	
		3.243	Struktura monolite betoni C 16/20 (muri mbajtes I kalldremit)	
		3.243/1	Struktura te holla monolite betoni C 16/20 shkarkuesi	
		2.133	Mure b/a per rezervuare~4m kendrejte C16/20, t=21-30cm	
		2.166/1	F.V hekur betoni periodik >12mm	
NP-6	Diga dhe Tunele Hidroteknike	An.	F.V saraqineske celiku me flanaxha elektrike, Pn 16bar, φ600	Niveli B
		4.146	F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x50mm ²	
		2.166/1	F.V hekur betoni periodik >12mm	
		An-1	Mbushje me argjile, hedhje, rrafshim e ngjeshje dheu ne trup dige me cilinder me dhembe	
		An-2	Prishje e veshjes me gure (kalldrem) ekzistues	

NP-9		An-5	Zhbllokim I kanalit fundor (shkateruesi) me sonde me presion uji dhe zevendesimi I pjeseshme I tubacionit ø600mm	Niveli B
		An-6	FV tub metalik ø 300 mm per kalimet ne rruge, kanali vadites	
		An-7	FV rezine epoxide per inskarkimin e ankorave te shkalleve ne kullen e kontrollit	
		An-8	Furnizim - vendosje porta metalike + çmontim egzistueset	
		An-9	Kontroll I tubacionit fundor me kamera (per demtime te tubit ne brendesi ose bllokime nga inerte)	
NP-12	Punime te inxhinjerise se mjedisit	An-10	Rehabilitimi I siperfaqes mjedisore te demtuara dhe kthimi ne gjendjen e mepareshme, rruga kanali, trupi I diges	Niveli A
		3.2	Prerje bime te vogla ø ~ 10cm	
		3.3	Preje e sistemim pemesh ø 10 ~ 20 cm	
		3.7	Preje e sistemim pemesh ø 10 ~ 20 cm	
		3.643	Mbjellje bari ne skarpat	
		An-1	Mbushje me argjile, hedhje, rrafshim e ngjeshje dheu ne trup dige me cilinder me dhembe	
Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme				
NS-18	Punime topogjeodezike	3.106/a	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji ~ 2m kategoria IV, me shk ne mjet	Niveli B
		3.124/2	Germim shkemb i forte me çekiç me ekskavator me zinxhir	
		3.89/b	Germim me ekskavator krahegjate, me gjatesi krahu mbi 20m	
		3.25/a	Germim me krahe ne seksion te detyruar me gjeresi b > 1 m, h=1.5 m, toke e bute.	
		2.701	Shtresë çakëlli	
		An	Shtrese me gur te sortiruar t (15-25) cm	
		2.262/5	Shtrese betoni C20/25 ushqyesi ne derdhje	

		3.366	Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni	
		An-1	Mbushje me argjile, hedhje, rrafshim e ngjeshje dheu ne trup dige me cilindër me dhembë	
		An-10	Rehabilitimi I sipërfaqes mjedisore të demtuara dhe kthimi në gjendjen e mëparshme, rruga kanali, trupi I diges	

Kategoria NP-1 B (Punime gjërmimi në tokë).

Konsiderohen gjërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise së punimeve operatori ekonomik duhet të disponojë këte kategori në nivelin B nga 21 deri në 50 milion lekë për këto punime.

Kategoria NP-4 A (Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale)

Konsiderohen ndërhyrje në shtresa sipas zerave të preventivit.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise së punimeve të cilat përfshijnë ndërtimin operatori ekonomik duhet të disponojë këte kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

Kategoria NP-5 B (Punime nentokesore, ura vepra arti)

Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për punimet nentokesore, infrastrukturë etj.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise së punimeve, operatori ekonomik duhet të disponojë këte kategori në nivelin B nga 21 deri në 50 milion lekë për këto punime.

Kategoria NP-6 B (Diga dhe Tunele Hidroteknike)

Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për punimet nentokesore, infrastrukturë si dhe diga, ku përfshihen zërat sipas preventivit etj.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise së punimeve, operatori ekonomik duhet të disponojë këte kategori në nivelin B nga 21 deri në 50 milion lekë për këto punime.

Kategoria NP-12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose rishikime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik.

Referuar zerave të preventivit kemi të bëjmë me punime si rehanilitim I sipërfaqes mjedisore të demtuar, prerje bime, prerje dhe sistemim pemesh, mbjellje bari në skarpate etj. Përfshihen dhe punime gjërmimi, heqje dherash etj, që kanë ndikim negativ në mjedisin përreth. Gjate zbatimit të projektit në realizimin e plote të kontratës, është e pamëshmueshme që në realizimin e punimeve të këte mbeturina e inerte të cilat janë të një rrezikshmërie të lartë për komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet të realizohet në përpikëri dhe në kohë reale. Për këte arsye operatori ekonomik duhet të disponojë këte kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

Kategoria NS-18 A (Punime Topogjeodezike)

Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike special që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike, piketime në nivele të ndryshme, shtresash, pllakash etjera.

Në këto objekt përfshihen edhe punime si piketimi, rlevime të ndryshme topografike në sisteme koordinative të ndryshme caktimi i kuotave të kërkuara nga projekti, azhurnime të ndryshme dhe lidhjet me sistemet koordinative relative dhe absolute. Për këto arsye operatori ekonomik duhet të disponojë këto kategori në nivelin A nga 0 deri në 50 milion lekë për këto punime.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Certifikatat ISO, si më poshtë:

- Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH EN **ISO 9001-2015** e përfitësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH EN **ISO 14001-2015** e përfitësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën SSH **ISO 45001:2018** e përfitësuar, (**SSH EN ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.14 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **80 tetedhjetë) punonjës**, për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori

ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

- ✓ Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
- ✓ Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv.

Numri i stafit kryesor dhe mbështetës është llogaritur në baze të volumeve dhe grafikut të punimeve.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

Minimumi 1 (nje)	Inxhinier Ndërtimi
Minimumi 1 (një)	Inxhinier Ndertimi Profili Transport
Minimumi 1 (një)	Inxhinier Ndertimi, profili Gjeoteknik
Minimumi 1 (një)	Inxhinier Hidroteknik
Minimumi 1 (një)	Inxhinier Gjeodet/ Topograf
Minimumi 1(një)	Inxhinier Mjedisi
Minimumi 1(një)	Inxhinier Mekanik
Minimumi 1 (një)	Inxhinier Gjeolog

Për drejtuesit teknik të paraqitet diploma, kontrata noteriale e punës, si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimalisht 3 (tre) muajt e fundit.

Per testimin e materialeve të ndërtimit, si dhe cilësinë e materialeve që do të perdoren në këtë kontratë, dy prej drejtuesve teknik të mesipër duhet të jenë të paisur me Certifikate për Testimin e Performances së Produkteve të Ndërtimit, certifikata të jete lëshuar nga instituti i ndërtimit, institucioni shtetëror përgjegjes

per testimin e materiale.

Argumentimi: Kërkesa është vlerësuar e nevojshme si kërkesë teknike pasi materialet e përdorura në këtë projekt duhet të jenë të garantuara sipas cilësive dhe standarteve bashkëkohore, Prandaj, testimi i besueshëm i materialit është metoda më efikase për të verifikuar se materialet e përdorura nga kompanitë në proceset e tyre të zbatimit do të përmbushin pritshmerite dhe do të përputhen me të gjitha rregulloret në fuqi.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për çertifikimin si më sipër kerkohet, emër/mbiemër, numrin dhe datën e çertifikates, si dhe institucionin/organizatën që ka lëshuar këtë dokument.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinjerët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafi i inxhinjerëve, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Inxhinieri i Ndërtimit kerkohet për zbatimin e saktë të punimeve strukturore të objektit që do të ndertohet, sipas parashikimeve në projektin dhe preventivin e punimeve.

Inxhinieri i Ndërtimi profili Transport kerkohet për zbatimin e saktë të punimeve me karakter transporti sic jane shtresat e ndryshme qe jane parashikuar ne projekt dhe preventivin e punimeve.

Inxhinieri i Ndërtimit i Profilit Gjeoteknik është i nevojshëm pasi ai do të verifikojë në terren kapacitetet mbajtëse të tokës dhe lidhjen e saj me tipin e zgjedhur për implementimin e pllakes së themelit. Inxhinjeri Gjeoteknik ka rëndësi të vecantë sidomos në rastin konkret me fushën e përcaktimit të karierave të

materialeve që do të përdoren për nenshtrese zhavori, për shtresë stabilizuese si dhe për materialet që do të përdoren për pllaken e themelit dhe për materialet e betoneve të tjera.

Prania e inxhinjerit të ndërtimit me profil gjeoteknike nevojitet për të kryer provat e duhura gjeoteknike, për të verifikuar përputhshmërinë e përbërjes së tokës me parametrat e cilësuar në projekt si dhe për të përcaktuar kuotën e tabanit ku sforcimet e reja duhet të jenë brenda sforcimeve të lejuara.

Inxhinieri Hidroteknik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidraulike, sistemin e kanalizimeve dhe shkarkimeve, lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin, sipas parashikimeve në projekt.

Inxhinieri Gjeodet /Topograf është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve gjeodezike duke përfshirë punime si piketimi, rievime të ndryshme topografike në sisteme koordinative të ndryshme caktimi i kuotave të kërkuara nga projekti, azhurnime të ndryshme, si dhe gjeoreferime të materialeve të ndryshme hartografike të cilat mund të jenë në shkallë të ndryshme.

Inxhinieri Mjedisit është i nevojshëm pasi kemi të bëjmë me punime germimi, ndërtimi, heqje dherash etj, që kanë ndikim negativ në mjedisin përreth. Gjate zbatimit të projektit, është e pashmangshme që në realizimin e punimeve të ketë mbeturina të inerte të cilat janë të një rrezikshmërie të lartë për komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet të realizohet në përpikëri dhe në kohë reale, prandaj asistencë e një inxhinieri mjedisi do të jetë e domosdoshme.

Inxhinieri Mekanik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv.

Inxhinier Gjeolog është i domosdoshëm për të parë faktorët gjeologjikë të tokës në sheshin e ndërtimit, është përgjegjës për zbatimin e punimeve gjatë germimit dhe do të jetë i nevojshëm për hartimin e një relacioni dhe studimi gjeologjik përpara se të fillohet me punimet gjeoteknike dhe konstruktive të objektit. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin e kualifikuar** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

1-Minimumi 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Struktural)

Për stafin teknik të paraqitet diploma universitare, kontrata e punës, si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimalisht 3 (tre) muajt e fundit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për të kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe Nenit 39, pika 6/c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin mbështetës lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislati për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezultojnë në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit të punimeve, si më poshtë:

- Teknik i Ndërtimi (diplome e shkollës së mesme) -jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Teknik Topograf (diplome e shkollës së mesme) - jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Teknik Hidroteknik (diplome e shkollës së mesme)- jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Hidraulik – jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Saldator – jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Hekurthyes - jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Kaperntier - jo më pak se **5 (pese)** punonjës
- Betonues – jo më pak se **3 (tre)** punonjës
- Specialist guri – jo më pak se **10 (dhjete)** punonjës
- Punëtorë të thjeshtë– jo më pak se **40 (dzyet)** punonjës

Operatori ekonomik duhet të paraqes për stafin e mesiperm: Kontratat individuale të punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Dëshmitë profesionale/ Dëshmi e Aftësisë Profesionale (DAP)/, Dëshmi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI(Perjashtohen puntoret e thjeshte nuk kerkohet Dëshmi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI) ose nga një trup certifikuese e akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

- *Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mesiperm , emer/mbiemer, profili i punes, numrin e amzës/regjistrat dhe datën e lëshimit, dhe emrin e institucionit që ka lëshuar dokumentin për specialistët e kualifikuar më sipër. (Në rast se institucioni lëshues i certifikatës/dëshmisë/diplomës është privat, duhet të deklarohet dhe NIPT-i).*

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesat e gërmes c) të pikës 2.3.4, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

- **Teknik Ndërtimi** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimin e punimeve të betonit, sipas zerave të preventivit të punimeve.
- **Teknik Topograf** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të ndërtimit sic jane piketimet e shtresave te ndryshme, piketimi I veprave te artit dhe rilevime te ndryshme sipa nevojës.

- **Teknik Hidroteknik** është i nevojshem për ndjekjen e realizimin e punimeve të ndërtimit, ndërtimi tombinove, mure b/a per rezervuare, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Hidraulik – 1 (nje).** Eshte i nevojshem per ndjekjen dhe realizimin e punimeve dhe instalimeve hidraulike sipas zerave te preventivit. Per punimet hidraulike eshte kerkuar nje numer minimal punonjesish hidraulike. Hidrauliku eshte i nevojshem per instalim saraqineske celiku me fllanxha si dhe vendosje tub metalik Ø 300 mm per kalimet ne rruge, kanali vadites.
- **Saldator – 1 (nje).** Eshte i nevojshem per realizimin e punimeve te saldimit sipas zerave te preventivit. Per punimet e saldimit eshte kerkuar nje numer minimal saldatoresh per saldimitin e fllanxhave te saracineskave si dhe saldime per porta metalike.
- **Hekurkthyes 1 (nje),** është i nevojshëm pasi në zërat e preventivit përfshihet përpunimi dhe lidhja e hekurit të ndërtimit duke përdorur mjetet e duhura, sipas zërave të preventivit të punimeve. Duke analizuar preventivin e punimeve vërejmë se punonjësit e mësipërm garantojnë autoritetit kontraktor për zbatimin e punimeve të hekurit.

Tek seksioni 9. P ANALIZA janë parashikuar punime si:

- 2.166/1	- F.V hekur betoni periodik >12mm	- 8.4ore pune
-----------	-----------------------------------	---------------

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për **Hekurkthyes 1 (nje).**

- **Karpentier 5 (pese)** janë të nevojshëm pasi në zërat e preventivit përfshihen punime betoni, armaturat/betonformat) per struktura monolite betoni, struktura te holla monolite betoni, tombino betoni etj., Ne kapitullin 3 ka shume volume punimesh me beton.
Konkretisht, vetëm për punime betoni janë parashikuar 7040 orë pune nga zërat e betonit.
Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se: $7040 \text{ ore pune} / 8 \text{ ore} = 880 \text{ dite pune}$
në total për 7 muaj ose 28 jave ose $28 \text{ jave} \times 6 \text{ dite/jave}$, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).
 $880 \text{ dite pune} / (28 \text{ jave} \times 6 \text{ dite/jave}) = 5.2 \text{ punonjes}$

Nga sa më sipër argumentuar, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa për disponimin nga ana e ofertuesve për 5 (pese) karpentierëve, është në përputhje me objektin e kontratës si dhe i shërben qëllimit të AK duke garantuar këtë të fundit për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Betonues 3 (tre) janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të betonimit, me klasen e duhur sipas zërave të preventivave të punimeve, duke marre parasysh qe kemi Shtrese betoni C20/25 ushqyesi ne derdhje, Struktura monolite betoni C 16/20 (muri mbajtes I kalldremit), Struktura te holla monolite betoni C 16/20 shkarkuesi, Mure b/a per rezervuare~4m kendrejte C16/20, t=21-30cm, ne volume te konsiderueshme.

Lidhur me kete kërkesë, njësia e prokurimit argumenton se duke analizuar preventivin e punimeve, jane rreth 8,131.60 ore pune per tu realizuar ne harkun kohor te 20 javeve.

Duke qënë se punimet e betonit janë në volume të mëdha si më sipër listuar, si dhe referuar orëve të punëve për këtë kategori punimesh ku është relativisht e madhe dhe konkretisht 8,131.60 orë pune(perfshire dhe karpentiere, njësia e prokurimit gjykon se kë kërkuar një numër minimal prej

3 punonjësish, duke garantuar autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

- **Specialist guri 10 (dhjete)** janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të shtreses me gur te sortiruar sipas zërave të preventivave të punimeve.

Lidhur me kërkesën e mësipërme, njësia e prokurimit argumenton se duke analizuar preventivin e punimeve, ne seksionin 3 jane parashikuar zërat:

Tek seksioni 3. PUNIME BETONI E BETONARMEJE kemi zerat si vijon:

Shtrese me gur te sortiruar t (15-25) cm - 33,913.0 ore pune.

Në total 33,913.0 orë pune gjithsej. Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se:

$33,913.0 \text{ ore pune} / 8 \text{ ore} = 4,239.13 \text{ dite pune}$ në total për 28 jave ose 28 jave x 7 dite/jave.

$4,239.13 \text{ dite pune} / (28 \text{ jave} \times 7 \text{ dite/jave}) = 21.62 \text{ punonjes guri}$ (perfshire dhe puntoret) të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për **10 (dhjete) specialiste guri** për plotësimin e punimeve te gurit.

2.3.5 **Operatorët Ekonomike duhet të kenë në stafin teknik ose mbështetës, të certifikuar të paktën:**

a- Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te disponojne **1 (një) punonjës** që disponon certifikatën si *“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”* në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

b- Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te disponojne **1 (një) punonjës** *“Ekspert Zjarrfikës”* në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, të pajisur me çertifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH, ose te kontrakohet nga ente/subjekte private.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë Diplomë / Certifikatat e cituara më sipër dhe te figurojne ne listpagesat e shoqerise 3 muajt e fundit nga data e hapjes se procedures.

Argumentimi: Në mbështetje të nenit 7 të Ligjit 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” ku citohet..... *“Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion”.*

Specialisti per sigurimin teknik dhe shendetin ne pune harton planin e sigurisë dhe të koordinimit ne kantier, parapërgatit një dosje, e cila përmban informacionet e nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen nga rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar punëtorët, hartojnë planin operativ të sigurisë, kryejnë mirëmbajtjen e kontrollin para fillimit të punës dhe kontrollin periodik të impianteve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve.

Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të

sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" dhe "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave", janë te nevojshëm për të menaxhuar emergjencat gjatë punimeve dhe të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit në punë.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për stafin teknik si me siper, emer/mbiemer, profili i punes, numrin e amzës/regjistrir dhe datën e lëshimit, dhe emrin e institucionit që ka lëshuar dokumentin për stafin e kualifikuar më sipër. (Në rast se institucioni lëshues i certifikatës/dëshmisë/diplomës është privat, duhet të deklarohet dhe NIPT-i).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

c-Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar:

- Eskavatoriste – jo më pak se **6 (gjashtë)** punonjës
- Automakini – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Shofere të mjeteve të rënda/kamioni – jo më pak se **3 (tre)** punonjës

Eskavatoriste 6 (gjashte), Automakinist 2 (dy), shofere 3 (tre)

Lidhur me kriterin e sipërcituar, njësia e prokurimit sqaron se punonjësit e mësipërm kërkohen në funksion të manovrimit të mjeteve të listuara si më poshtë;

Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 20 ton (cope 1), Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 10-12 ton (cope 1), Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 12 – 18 ton (cope 2), Kamion me Vinc (cope 2), Kamionçina me kapacitet mbajtes deri ne 2-3.5 ton (cope 2), Kamionçina me kapacitet mbajtes deri ne 1.5-2 ton (cope 1) , Eskavator (cope 4), Rul gome hekur me peshe jo me te vogel se 18 ton (cope 1), Eskavator me krahe te gjate mbi 18 m(cope 1), Eskavator me goma MT(cope 1), Fadrome me goma MT(cope 2), Minieskavator (cope 2), Minifadrome me zinxhir gome/Bobcat (cope 1)

AK është në të drejtën e tij të parashikoj kriteret minimale kualifikuese, duke gjykuar se këto punime mund të zgjaten edhe përtej një afati 1 muaj, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6 në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruar janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- (Dëshmi te Aftësisë Profesionale), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor, e cila duhet të perkojë me kërkesat e profilin të deklaruar për çdo punojes.
- Të figurojnë në listëpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punonjësit e mësipër duhet të figurojnë të regjistruar sipas legjislacionit në fuqi.
- Gjate fazes se ofertimit në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pika B. Deklarata -“Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik për punonjesit eskavatoriste, automakinist, buldozerist, duhet të deklarojnë: emer/mbiemer, profilin e punes, daten e kontrates se punes, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe daten e vlefshmerise se saj.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere eskavatorist / buldozeristet , automakinistet, dhe shoferet nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

AK rezervon te drejten e verifikimit te deklarimeve per punojesit e mesiperm, cdo informacion i rreme apo i devijuar nga kerkesat e mesiperme do te jete kusht per skualifikimin e ofertes.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te paraqese Kontate Furnizimi Per Materialet si me poshte:

2.1 Tombino me tuba betoni, Autorizim Prodhuesi/Distributori te autorizuar te paraqitet kataloget perkates dhe ISO 9001/ekuivalente per cilesine

2.2 Hekur Autorizim Prodhuesi/Distributori te autorizuar te paraqitet kataloget perkates dhe ISO 9001/ekuivalente per cilesine

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.7 gërma “2.1”- “2.2” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”,* si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,* ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

2.3.8 **(Makineri, Pajisje)**

a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet, makineritë dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes min 20 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 10-12 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 12 – 18 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Kamion me vinç	2 cope	Pronësi ose me qera
Kamioncine me kapacitet mbajtes 2-3.5 ton	2 cope	Pronësi ose me qera

Kamioncine me kapacitet mbajtes 1.5 – 2 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Rimorkiator RTV.	1 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhire	4 cope	Pronësi ose me qera
Rul gome hekur me peshe jo me te vogel se 18 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me krahe te gjate mbi 18 m	1 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma MT	1 cope	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma MT	2 cope	Pronësi ose me qera
Minieskavator	2 cope	Pronësi ose me qera
Mini fadrome me zinxhir gome	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 cope	Pronësi ose me qera
Grejder	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 cope	Pronësi ose me qera
Autopompë betoni	2 cope	Pronësi ose me qera
Betonierë kantieri 0.5m ³	4 cope	Pronësi ose me qera
Betoforma (armaturë, kallëp) dërrase	500 m2	Pronësi ose me qera
Pajisje për hekurthyes (tranxhë / elektrobango)	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator beton	4 cope	Pronësi ose me qera
Tokmak për ngjeshje dheu (kompatator)	2 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	2 cope	Pronësi ose me qera
Gjenerator	2 cope	Pronësi ose me qera
Kontenier (Zyrë Kantieri)	1 cope	Pronësi ose me qera
Impiant (fabrikë) prodhim betoni e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B)	1 cope	Pronësi ose me qera

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimit.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë

aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

- **Kamion veteshkarkues me kapacitet mbi 20 ton** (1 cope); Kerkohen kamionat pasi kemi transport te volumeve qe dalin nga punimet e germimit.

3.106/a	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji ~ 2m kategoria IV, me shk ne mjet
3.124/2	Germim shkemb i forte me çekiç me ekskavator me zinxhir
3.89/b	Germim me ekskavator krahegjate , me gjatesi krahu mbi 20m
3.25/a	Germim me krahe ne seksion te detyruar me gjeresi b > 1 m, h=1.5 m, toke e bute.

- **Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 10-12 ton;** Kerkohet kamioit pasi kemi transport te volumeve qe dalin nga punimet e germimit.
- **Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 12 – 18 ton;** Kerkohet kamioit pasi kemi transport te volumeve qe dalin nga punimet e germimit.
- **Kamion me vinc;** prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe proceset si transportin dhe ngritjen me vinc te materialeve , tombino me tubo betoni etj
- **Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 2-3.5 ton** (2 cope); prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe proceset si Transport i mbeturinave etj. Ky mjet është i favorshem pasi mund te qarkulloje ne cdo orar per kryerjen e furnizimit me material
- **Kamioncine me kapacitet mbajtes 1.5 – 2 ton** (1 cope); Prezenca e saj në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe proceset si Transport i veglave te punes etj. Ky mjet është i favorshem pasi mund te qarkulloje ne cdo orar per kryerjen e furnizimit me material.
- **Rimorkiator RTV** (1 cope); Prezenca e këtij mjete në kantieret e ndërtimit garanton lëvizjen e mjeteve te renda(eskavatore, rula etj)
- **Eskavator me zinxhirë** (4 cope); Kerkohen eskavatoret pasi kemi germim te dheut, pastrim dhe heqje aluvionesh, Rehabilitimi I siperfaqes mjedisore te demtuara dhe kthimi ne gjendjen e mepareshme, rruga kanali, trupi I diges etj.
- **Rul gome hekur me peshe jo me te vogel se 18 ton** (1 cope); Prezenca e këtij mjete në kantieret e ndërtimit garanton punimet per ngjeshjen e shtresës se cakellit.

- **Eskavator me krahe te gjate mbi 18 m** (1 cope); Ky mjet ben te mundur realizimin e punimeve te gërmimit ne trupin e digës dhe ne kanale pasi nuk mund te realizohen nga eskavatoret normale.
- **Eskavator me goma MT** (1 cope); Ky mjet ben te mundur realizimin e punimeve te gërmimit per vendosjen e tombinove.
- **Fadrome me goma MT** (2 cope); Kerkohen fadroma pasi perdoren per hapjen e kanaleve te ngushta si dhe perdoren per transport te materialeve inerte, tubo betoni etj brenda kantierit.
- **Minieskavator** (2 cope); Kerkohen minieskavatore per germime te vogla te cilat do te behen ne shesh per kanalizimet dhe tubo metalik per kalimet ne rruge.
- **Mini fadrome me zinxhir gome** (1 cope); Ky mjet ben te mundur realizimin e punimeve te transportit te materialeve te imta ne vende te vështira ku hapësirat janë te vogla.
- **Autobot uji (1 cope)**; Ky mjet eshte i nevojshem per lagjen e materialit ne realizimin e shtresave te betonit..
- **Grejder (1 cope)**; Ky mjet eshte i nevojshem per hapjen e materialit ne realizimin e shtresave te cakellit.
- **Autobetoniere (2 cope) Autopompe betoni 1 copë**, Prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve te betonit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me nevojen për përgatitje dhe hedhje betoni për zerat si më poshtë;

3.243	Struktura monolite betoni C 16/20 (muri mbajtes I kalldremit)
3.243/1	Struktura te holla monolite betoni C 16/20 shkarkuesi

- **Betoniere kantieri (4 cope)**; prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të betonit me sukses ne pozicionet ku nuk mund te hyjne mjetet e renda . Kjo kërkesë përputhet me nevojen pergatitje betoni.
- **Betoforma (armaturë, kallëp) dërrase 500 m2**; Prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht per betonim e murit mbajtes, Struktura te holla monolite betoni C 16/20 shkarkuesi etj.
- **Pajisje për hekurkthyes (tranxhë / elektroango) (1 cope)**; prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të hekurit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me nevojen per kthimin e hekurit te ndertimit sipas projektit.
- **Matrapik (2 cope)**; prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të prishjes me sukses. Kjo kërkesë përputhet me nevojen e Prishje e veshjes me gure (kalldrem) ekzistues.

- **Vibrator beton (4 cope);** prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të betonit me sukses . Kjo kërkesë përputhet me nevojën e vibrimit të betonit sipas kërkesave.
- **Tokmak për ngjeshje dheu (kompatator) (2 cope);** prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve sipas preventivit. Kjo kërkesë përputhet me nevojën e realizimit për ngjeshjen e cakellit aty ku nuk mund të hyjë rruli.
- **Saldatrice (2 cope);** Prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht për saldimin e tubove, porta metalike etj.
- **Gjenerator (2 cope);** Prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht për sigurimin e energjisë elektrike për saldatricet që përdoren në saldimin e tubove, porta metalike etj.
- **Kontenier (Zyrë Kantieri) (1 cope);** prezenca e saj në kantieret e ndërtimit është e domosdoshme pasi shërben si strukturë e perkohshme në vendin e ndërtimit për të ruajtur dokumente, projekte, kompjuter etj.
- **Implant (fabrikë) prodhim betoni e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B) (1 cope);** Është e domosdoshme për sigurinë e prodhimit të betonit për hedhjen në veper.

Për të dhënë kete, Formulari i shtojcës të DST duhet të shoqërohet me dokumentat e mëposhtme:

- 1- **Për mjetet me goma që shënohen në rregjistrin publik** duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe foto e dukshme të mjetit.
- 2- **Për mjetet e siguruar me qira**, të paraqitet kontrata e lidhur për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 3- **Për pajisjet/ makineritë në pronësi** të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).

4- **Për paisjet/ makineritë me qera** të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimit*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (të paktën 1).

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – jo më pak se 80 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë – jo më pak se 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme – jo më pak se 5 copë
- Jelek – jo më pak se 80 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – jo më pak se 10 copë
-

2.3.9.Operatorët ekonomikë, duhet të kenë 1 (një) Impiantin e prodhimit të betoni, (jo me shume se 50 km larg objektit) dhe duhet të paraqesë Raport Vetemonitorimi planvendosjen dhe projektin teknologjik. Për fabriken e betonit duhet të paraqiten dokumentet e pronësive si akte zhdoganimit ose fatura tatimore të blerjes, leja mjedisore e leshuar nga QKL kodi III.1.B + Akt-Miratimin(Nuk kerkohet leja mjedisore e leshuar nga QKL kodi III.1.B + Akt-Miratimin në rastin kur Impiantin e prodhimit të betoni është me kontratë furnizimi) . Në rastin e fabrikes/linjes me qera/kontrate furnizimi dokumentet e mesiperme duhet të shoqërohen me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në këtë rast operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin ligjor që verëton pronësinë e tij (fatura tatimore/zhdoganimit ose kontratë shitblerjeje si dhe e shoqëruar me foto)

2.3.9 Leje mjedisore e leshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit për ” Për grumbullim, transportim të mbetjeve të llojeve të ndryshme” më Kod III.2.B.

2.3.10 Leje mjedisore e keshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit për ” Sherbime ekspertize dhe /ose profesionale lidhur me ndikim në mjedis” më Kodi III.2.A

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të kenë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN SSH EN 12350-2:2019, SSH EN 12504-2:2021, SSH EN ISO 6892 - 1:2019, SSH EN 12390-8:2019.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar, preventivin (Bashkëlidhur DST) në dokumentat e tenderit. Në rast BOE, grafikun e punimeve duhet të jetë i firmosur dhe vulosur nga secili prej administratoreve perkates.

Argumentimi: Referuar preventivit të punimeve dhe natyrës së punimeve që do të kryhen, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të disponojnë dhe liçencat e nevojshme lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për zbatimin e punimeve objekt kontrate, si më poshtë, argumentojmë:

Duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (*dheu*), dhe kryerjen e transportit të tyre, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “*Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte*” **ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë liçencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të liçencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B)** sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “*Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*”, nga institucioni kompetent që lëshon këto liçenca (Qendra Kombëtare e Liçencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “*Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta*”.

Kërkesa e mësipërme për Kodi III.2.B, është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 dhe 4, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, nenin 39, pika 6/a, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Po ashtu, referuar natyrës së punimeve që do të kryhen, në zbatim nenit 25 të ligjit nr. 10 431, datë 09.06.2011 “*Për mbrojtjen e mjedisit*” (i ndryshuar), nenit 6 pika 1 dhe nenit 20 pika 4 të ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 “*Për Vlerësimin e ndikimit në Mjedis*” (i ndryshuar), **duke qënë se Op. Ek. Pjesëmarrës, në cilësinë e zbatuesit të punimeve duhet të raportojë pranë autoritetit kontraktor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të liçencuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis (Kodi III.2.A)** në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave me Nr. 538, datë 26.05.2009 “*Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta*”

Analiza e specifikimeve teknike është bere me dokument te vecante Specifikimet teknike.

Njesia e prokurimit